



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



*To futet në procedurë
për të miratuar
në kuvendin më 20.12.18*
[Signature]

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2018

Lënda: Depozitohet projekt-vendim për miratim në seancë plenare

**Zotit Gramoz RUÇI
Kryetar i KUVENDIT**

Në cilësinë tonë si deputetë dhe Kryetarë të Komisioneve të Përhershme Parlamentare, Ju përcjellim:

Projekt-Vendim “Për Miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik” si dhe Relacionin bashkëlidhur.

Projekt akti propozohet në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 80, të Kushtetutës, të neneve 18, 55, 102, 103, 120 dhe 121, të Rregullores së Kuvendit, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjeve organike të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj si dhe Vendimit Nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

Erjon BRACE

**KRYETAR I KOMISIONIT
TË EKONOMISË DHE FINANCËVE**

[Signature of Erjon Brace]

Ulsi MANJA

**KRYETAR I KOMISIONIT
TË ÇËSHTJEVE LIGJORE
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE TË DREJTATË NJERIUT**

[Signature of Ulsi Manja]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTVENDIM

Nr. ____2018

PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË MONITORIMIT VJETOR DHE PERIODIK

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 80, të Kushtetutës, të neneve 18, 55, 102, 103, 120 dhe 121, të Rregullores së Kuvendit, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjeve organike të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj si dhe Vendimit Nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet manuali i monitorimit vjetor dhe periodik, i cili do të shërbejë për zbatimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, sipas lidhjes bashkëlidhur.

II. Institucionet e pavarura, institucionet qendrore të administratës shtetërore dhe Kuvendi bashkëpunojnë dhe referojnë në këtë manual gjatë ndjekjes dhe zbatimit të miratuar me Vendimin Nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”

III. Ngarkohen organet e Kuvendit dhe shërbimet e Kuvendit për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën _____

MANUALI I MONITORIMIT VJETOR DHE PERIODIK

HYRJE

Ky manual rregullon dhe detajon Mekanizmin e miratuar me vendimin nr 49/2017 të Kuvendit “Për monitorimin e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të atyre të krijuara me ligj të veçantë” si dhe parashikon mënyrën, afatet dhe përgjegjësitë për bashkërendimin me ekzekutivin të veprimtarisë monitoruese të Kuvendit si pjesë e kontrollit parlamentar.

PJESA I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR RAPORTIMIN E INSTITUCIONEVE NË MONITORIM

I. Raportimi Vjetor në Kuvend, në funksion të shqyrtimit të veprimtarisë së institucionit dhe miratimit të Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë:

1. Rregulla procedurale

Institucionet e Pavarura Kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj të veçantë, që këtu dhe më poshtë do të quhen “institucione në monitorim” e që i nënshtrohen detyrimit për raportim në Kuvendin e Shqipërisë, miratojnë dhe paraqesin Raportin Vjetor sipas afateve të parashikuara në ligjet që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

Në fillim të çdo viti, mundësisht brenda datës 15 janar, institucionet në monitorim referojnë afatin brenda të cilit ata besojnë se do të jetë miratuar Raporti Vjetor. Ky parashikim është i nevojshëm për t’i bërë me dije Kuvendit rrethana apo kushte të caktuara për shkak të të cilave, institucioni mund të ndodhet ose rezultojë në vonesë në lidhje me afatin e parashikuar nga ligji për miratimin e Raportit Vjetor.

Pas shqyrtimit të informacioneve të mbërritura nga institucionet në monitorim, Kryetari i Kuvendit, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit, i përcjell Konferencës së Kryetarëve, kalendarin e fillimit të procedurave parlamentare të shqyrtimit në Komisione dhe miratimit në seancë plenare të projektrezolutës për secilin institucion në monitorim, duke referuar tek afatet që ligji i posaçëm ka parashikuar për detyrimin për raportim.

Kalendari i miratuar publikohet dhe i bëhet me dije të gjitha institucioneve nëpërmjet Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit.

Pas njoftimit në Kuvend të kalendarit të miratuar në Konferencën e Kryetarëve, komisionet e përhershme parlamentare hartojnë kalendarët përkatës për institucionet në monitorim, sipas fushës së përgjegjësisë.

Brenda dy javësh nga depozitimi në Kuvend të Raportit Vjetor, komisioni i përhershëm parlamentar, që ka kompetencën për shqyrtim dhe përgatitje të projektrezolutës për vlerësimin e

veprimtarisë, organizon seanca dëgjimore të veprimtarisë nga titullari dhe përfaqësues të tjerë të institucionit në monitorim.

Në Seancën dëgjimore të organizuar me komisionin përgjegjës, fjala prezantuese e përfaqësuesit të institucionit, duhet të jetë një përmbledhje që nuk mund të zgjasë më shumë se 20 minuta.

Bashkëlidhur këtij vendimi janë:

- formati i raportit të Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit me analizën e monitorimit të veprimtarisë së institucionit në monitorim;
- formati i raportit të komisionit parlamentar, për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit në monitorim;
- formati i rezolutës që miratohet në komision dhe i përcillet seancës plenare.

2. Dokumentet që shoqërojnë Raportin Vjetor të institucionit në monitorim

Për qëllim të shqyrtimit të veprimtarisë së çdo institucioni në monitorim, të hartimit të raportit të komisionit për vlerësimin e veprimtarisë, projektrezolutës bashkëlidhur raportit të komisionit të përhershëm parlamentar, që i përcillet për shqyrtim dhe miratim seancës plenare dhe, në funksion të identifikimit të të dhënave dhe informacioneve të posaçme që janë pjesë e hartimit të raporteve përmbledhëse ose statistikave nga Kuvendi, institucioni në monitorim, bashkë me Raportin Vjetor i përcjell në rrugë elektronike Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit edhe:

- a) një raport përmbledhës (jo më shumë se 6 faqe), në të cilin të përshkruhet në tërësi raporti dhe jep një pasqyrim të përgjithshëm të punës së institucionit, ecures dhe synimeve për të ardhmen, duke detajuar objektivat që ka institucioni për vitin pasardhës, si dhe një parashikim në terma afatmesme, deri në 3 vjeçare, në lidhje me vizionin e institucionit;
- b) materiale shpjeguese ose sqarime për çështje të caktuara që nevojiten të detajohen gjatë fazës së hartimit të raportit të Monitorimit, raportit të komisionit parlamentar, apo projektrezolutës.

3. Çështje që duhet të përfshihen në përmbajtjen e Raportit Vjetor të institucionit në monitorim

Institucioni në monitorim duhet të kujdeset që, edhe në rastet kur ligji i posaçëm ka identifikuar listë të çështjeve që duhet të përmbajë Raporti Vjetor, të referojë në çdo rast në Raport edhe:

- a) mesazhin e titullarit të institucionit, apo organit drejtues në rastin e organeve kolegjiale;
- b) referencat në ligjin/ligjet mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit në monitorim;
- c) gjendjen ose nivelin e respektimit apo plotësimit nga institucioni në monitorim të detyrimeve ndërkombëtare, nëse ka të tilla, dhe nëse nuk ka të bëhet deklarimi i qartë për mungesën e këtyre detyrimeve;

c) pikë të posaçme shpjegimesh për rekomandimet e “Progres Raportit të BE-së për Shqipërinë” dhe shkallën e përmbushjes së këtyre rekomandimeve nga institucioni në monitorim, nëse progresi ka rekomandime që duhen plotësuar prej institucionit;

d) sqarim i detajuar për nivelin e zbatimit të Rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë, duke listuar aktet e miratuara apo veprimet institucionale të ndërmarra;

dh) ndryshimet që i janë bërë kuadrit rregullator në vitin për të cilin hartohet raporti dhe efekti që kanë sjellë (nëse ka patur të tilla);

e) në rastin e organeve kolegjiale të institucioneve që ndjekin qëllime mbikqyrje tregjesh ose operatorësh, vendimmarrjen gjatë vitit për të cilin raportohet dhe problematikat e hasura e që kanë nxitur nevojën për atë vendimmarrje;

ë) në rastet kur ligji ka parashikuar tagrin për kryerje inspektimesh ose hetimesh administrative, të dhëna lidhur me aktivitetin institucional në fushën që mbulon, të gjeneruara me sistem statistikash në raport me vitet e fundit e në çdo rast duke u krahasuar së paku me vitin e mëparshëm;

f) vlerësimin për nivelin e zbatimit të detyrimeve ligjore nga vetë institucioni në monitorim dhe përgjegjësitë në rastet kur ligji është shkelur apo nuk është konsideruar;

g) statusin e zbatimit të rekomandimeve që institucione të tjera kushtetuese ose të pavarura kanë dhënë për institucionin në monitorim, duke trajtuar në mënyrë të veçantë raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nëse ka;

gj) listë të pëmbledhur të rekomandimeve të lëshuara nga institucioni në monitorim për institucione të tjera, si dhe të dhëna për institucionet që refuzojnë zbatimin e rekomandimeve;

h) nevojën për ndryshime në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit ose në përgjithësi në ligje, akte nënligjore apo dispozita që janë detyruese për institucionin në monitorim;

i) organizimin e brendshëm të Institucionit duke përfshirë strukturën dhe organigramën;

j) të dhëna për të ardhurat dhe shpenzimet përfshirë fondet e përfituara nga donatorë nëse ka patur;

k) listë të kallëzimeve penale dhe proceset gjyqësore në vijim, nëse ka;

4. Raportimi i Bankës së Shqipërisë në Kuvend

Përveç sa parashikohet për të gjitha institucionet në monitorim, formati i raporteve që hartohen, miratohen dhe më pas përcillen në Kuvend nga Banka e Shqipërisë, për sa i takon përmbajtjes së Raportit Vjetor, duhet të mbajë në konsideratë edhe:

- a) trajtimin e problemeve në masën e duhur në funksion të transparencës dhe duke referuar tek shembuj nga autoritete mbikqyrëse bankare të vendeve të Europës;
- b) përcjelljen e informacionit me gjuhë të qartë, duke synuar sqarimin e çdo problematike;

Për raportimin vjetor të Bankës së Shqipërisë duhet mbajtur në konsideratë fakti që BSH ka një raport specifik me Kuvendin, për shkak se auditimi i Bankës së Shqipërisë, bëhet në nivel profesional dhe të vazhdueshëm nga Inspektori i Përgjithshëm, i emëruar me vendim Kuvendi, dhe në praktikë ka rritur kompetencat si rrjedhojë e zhvillimeve, kryesisht pas krizës ekonomike. Për këto arsye, faza e shqyrtimit të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë duhet të përfshijë trajtimin si pikë më vete, të identifikuar qartë, çdo grup problemesh madhore që trajton BSH, të grupuara përafërsisht si në vijim:

a) Analizat e zhvillimeve ekonomike në vend, (ligji parashikon që BSH duhet të analizojë në raport të veçantë zhvillimet ekonomike dhe të prodhojë çdo tre muaj një raport të tillë), si pikë me vete;

b) Analizat e zhvillimeve në çmimet e konsumit, inflacion dhe zhvillimet monetare, (sipas ligjit prodhohet çdo gjashtë muaj një raport i posaçëm për zhvillimet monetare);

c) Stabiliteti financiar, (sipas ligjit, BSH nuk ka objektiva të drejtpërdrejta për stabilitetin financiar. Megjithatë këtë funksion BSH e ka zhvilluar si rrjedhojë e detyrave që lindën për bankat qendrore pas krizës së vitit 2008). Deklaratat 6-mujore të stabilitetit financiar bëhen pjesë e vlerësimit vjetor të veprimtarisë duke u bashkuar dy për gjashtëmujorët më të fundit. Nëse Komisioni përgjegjës e vendos, në këtë raportim mund të ftohet GKSF, (Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar, që parashikohet në ligjin për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare e që përbëhet nga Ministri i Financave+Guvernatori i Bankës së Shqipërisë+Kryetari i Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare).

ç) Mbikëqyrja bankare, (sipas ligjit, BSH ka detyra të qarta për mbikëqyrjen e bankave dhe për shkak të veçantisë së sektori bankar Komisioni Përgjegjës mund të vendosë të kërkojë raport dhe seancë të dedikuar për këtë aktivitet, duke parë mundësinë që raportimi për mbikëqyrjen bankare të kombinohet me raportimin për stabilitetin financiar).

d) Aktiviteti i BSH, (sipas ligjit BSH duhet të raportojë në Kuvend për aktivitetin e vet që lidhet me buxhetin; investimet; emisionin e parasë; zhvillimin e aftësive të personelit; strukturat; zbatimin e standardeve të transparencës etj. Kësaj pjese të Raportit Vjetor i bashkëlidhet opiniononi i përgatitur nga Inspektori i Përgjithshëm).

Gjatë hartimit të Raporti Vjetor, Banka e Shqipërisë duhet të mbajë parasysh që qëllimi i hartimit të një raporti vjetor është, midis të tjerash, përcjellja e mesazhit/mesazheve për publikun, tregun dhe operatorët në treg. Për këtë qëllim Banka e Shqipërisë duhet orientohet drejt përdorimit të një gjuhe mjaftueshëm të kuptueshme. Në rast se kjo është e pamundur të bëhet në raportin teknik, atëherë në Kuvend dërgohet edhe një raport tjetër, i cili, në funksion të transparencës, duhet të trajtojë informacionin në gjuhë të thjeshtë, të qartë, të mjaftueshme dhe të kuptueshme nga perspektiva e lexuesit, për të bërë të mundur që mesazhi/mesazhet të përcillen me efektivitet.

5. Rregulla të posaçme për kategori të veçanta institucionesh të pavarura

Institucionet e pavarura, që për shkak të veprimtarisë së tyre specifike, ushtrojnë kompetenca kontrolli në të gjitha institucionet qendrore, të vartësisë ose institucione të tjera të pavarura apo edhe kushtetuese, vlerësohet se kanë rol të posaçëm në identifikimin e problematikave në funksion të mekanizmit të monitorimit, (p.sh. Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit, etj.). Këto institucione, përveç raporteve vjetore, duhet të përcjellin në Kuvend edhe:

a) raporte pëmbledhëse çdo gjashtë muaj për gjetjet e tyre dhe

b) rast pas rasti, raportime të veçanta për çështje që i vlerësojnë si të një rëndësie të madhe.

Titullarët e këtyre institucioneve janë përgjegjës për përcjelljen e informacioneve dhe për zbatimin e detyrimit sipas kësaj pike.

II. Informimi periodik, rast pas rasti dhe mbështetja buxhetore në Kuvend

1. Informimi periodik

Institucioni në monitorim, menjëherë pas miratimit të Rezolutës së Kuvendit, harton dhe vë në funksionim, një kalendar masash dhe personat e ngarkuar brenda institucionit për fillimin e zbatimit dhe ndjekjen e plotësimit të rekomandimeve të Kuvendit. Institucioni në monitorim gjatë vitit, i përcjell:

a) çdo katër muaj pas miratimit të rezolutës, Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit, informacione shpjeguese për nivelin e zbatimit të Rekomandimeve të Kuvendit, duke detajuar masat e marra, projektaktet në proces ose akte të miratuara dhe vendimmarrje, në lidhje me çdo pikë të rezolutës. Ky informacion është i nevojshëm me qëllim përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e përmbledhjeve gjashtë-mujore nga Shërbimi i Monitorimit;

b) brenda muajit dhjetor, dërgohet zyrtarisht informacioni i plotë dhe përfundimtar për nivelin e zbatimit të rekomandimeve me shpjegimet si në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) çdo katër muaj, Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit, material informues për rekomandime të dhëna për institucione të tjera, në rastet kur institucioni në monitorim, ka tagrin ligjor për dhënien e rekomandimeve. Ky informacion është i nevojshëm me qëllim përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e përmbledhjeve gjashtë-mujore nga Shërbimi i Monitorimit;

ç) raporte periodike në komisionin përgjegjës për çështje të caktuara, siç mund të parashikohet rast pas rasti nga Raporti i Komisionit, nga Rezoluta e Kuvendit ose nga vendime të komisionit përgjegjës.

2. Informimi rast pas rasti

Informimi rast pas rasti ka lidhje me:

a) raportime për zbatimin e rezolutës së Kuvendit sipas parashikimeve të këtij manuali dhe sa herë që kërkohet nga Kuvendi;

b) kërkesa për informim për çështje të veçanta që konstatohen gjatë vitit.

3. Kërkesat për mbështetje buxhetore

a) Kërkesat për ndryshim në strukturë dhe organikë të institucioneve në monitorim, e që nuk kërkojnë mbështetje buxhetore, bëhen përgjithësisht në periudha kur në kalendarin e Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare, është shqyrtimi për miratimin e projektbuxhetit për vitin në vijim ose gjatë ndryshimeve në buxhet.

b) Kërkesa të tjera, që kërkojnë mbështetje buxhetore bëhen vetëm në kuadër të miratimit të projektbuxhetit të vitit pasues, i përcillen Kuvendit të paktën dy javë përpara datës së parashikuar në kalendarin e shqyrtimit të projektbuxhetit. Ky kalendar i përcillet institucioneve në monitorim menjëherë pas miratimit. Pasi marrin dijeni për kalendarin, institucionet në monitorim depozitojnë buxhetin faktik 9 muajor.

c) Kur kërkesat për mbështetje buxhetore, dërgohen në periudha të tjera të vitit, institucioni në monitorim duhet të mbajë në konsideratë që ajo kërkesë në çdo rast do të mund të shqyrtohet vetëm kur në kalendarin e Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare, do të jetë shqyrtimi i projektakteve për miratimin e buxhetit të shtetit, ose ndryshimeve në buxhet.

Në çdo rast kërkesa duhet të përmbajë të dhëna për:

- a) Bazën ligjore mbi të cilën mbështetet kërkesa për ndryshime strukturore;
- b) Analizë të shkaqeve dhe nevojave për ndryshime strukturë;
- c) Impakti që pritet të kenë ndryshimet në strukturë në veprimtarinë e institucionit;
- ç) Kostot buxhetore të ndryshimeve strukturore.

Kërkesës duhet t'i bashkëlidhet komunikimi i plotë, i bërë paraprakisht me Ministrinë e Financave dhe Departamentin e Administratës Publike.

PJESA II RREGULLA PËR TITULLARËT E INSTITUCIONEVE QENDRORE TË ADMINISTRATËS SHETËRORE QË KANË FUNKSIONE KOORDINUESE DHE RAPORTUESE NDAJ KUVENDIT

I. Përgjegjësitë e Ministrit të ngarkuar me marrëdhëniet me Kuvendin

Në funksion të analizës dhe përpunimit të të dhënave të lidhura me procesin e monitorimit, si pjesë e veprimtarisë së kontrollit parlamentar, komisionet parlamentare, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe shërbimet e kuvendit sipas rastit, presin dhe/ose koordinojnë raporte që i vihen në dispozicion Kuvendit nga institucione qendrore të administratës shtetërore.

Ministri për marrëdhëniet me Kuvendin, të paktën një herë në vit, harton dhe i propozon Këshillit të Ministrave për shqyrtim dhe miratim një projektakt për statusin e zbatimit të rekomandimeve që institucione të pavarura kanë dhënë për institucione qendrore të administratës publike.

Një herë në gjashtë muaj, Ministri përgjegjës për marrëdhëniet me Kuvendin, i dërgon Kryetarit të Kuvendit, informacion të detajuar si më poshtë:

- në lidhje me gjetjet e KLSH-së gjatë auditimeve të kryera nga KLSH në institucionet qendrore dhe ato të vartësisë të administratës publike.

Ky raportim duhet të përmbajë gjithashtu të dhëna për statusin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga KLSH, (të grupuara sipas institucionit ku është kryer auditimi) dhe për arsyet e refuzimit të zbatimit të rekomandimeve. Të dhënat e dërguara përpunohen nga Shërbimi i Monitorimit dhe bëhen pjesë e trajtimit gjatë seancave të raportimeve me KLSH-në dhe, në rastet kur vlerësohet nga komisionet parlamentare përgjegjëse, bëhen objekt i trajtimit gjatë seancave dëgjimore ose të tjera, ku thirren të marrin pjesë institucione qendrore apo vartësie ose titullarë institucionesh qendrore të administratës publike;

- në lidhje me gjendjen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit;
- në lidhje me gjendjen e zbatimit të rekomandimeve që institucione të tjera pavarura, kanë dhënë për institucione qendrore të administratës publike.

Ministri Përgjegjës për marrëdhëniet me Kuvendin, nëse kërkohet, mund të thirret nga komisionet parlamentare, në seanca të posaçme ku trajtohen informacionet e detajuara, sipas parashikimeve të kësaj pjese.

II. Detyrimi i institucioneve të veçanta të administratës qendrore për raportim në Kuvend

Ligje të veçanta kanë parashikuar detyrimin që, për shkak të rëndësisë të veprimtarisë ose të një veprimtarie specifike, institucionet e administratës qendrore të raportojnë në Kuvend.

Seancat e raportimeve për këto institucione, në komisionet parlamentare, organizohen sipas të njëjtës procedurë me raportimin për institucionet e pavarura dhe ato kushtetuese.

Komisioni parlamentar përgjegjës është ai i parashikuar nga ligji dhe në rast se ligji nuk e parashikon, caktohet nga Konferenca e Kryetarëve në përputhje me veprimtarinë e institucionit raportues dhe lëndës që trajtohet nga raporti.

Shërbimi i Monitorimit përgatit listën e institucioneve të veçanta të administratës publike, që për shkak të rëndësisë të veprimtarisë apo të një veprimtarie specifike, detyrohen nga ligji i posaçëm që të raportojnë në Kuvend dhe kjo listë bëhet pjesë e kalendarit të raportimeve vjetore, ose e kalendarit të komisionit përkatës për kontrollin parlamentar.

Komisioni parlamentar përgjegjës, organizon seancat dhe përgatit në çdo rast një raport për çështjet e trajtuara dhe propozimet për zgjidhje. Nëse Komisioni parlamentar vendos, raporti i përcillet për shqyrtim dhe miratim seancës plenare, i shoqëruar me projektrezolutën përkatëse.

Nëse Komisioni Parlamentar, vendos që nuk është e nevojshme që raporti t'i përcillet seancës plenare, në çdo rast e publikon atë dhe vë në dijeni Kryetarin e Kuvendit, i cili e njofton në seancën plenare më të parë.

PJESA III RREGULLA PER ORGANET E KUVENDIT QË JANË OSE BËHEN PJESË E PROCESIT TË MONITORIMIT DHE RAPORTI I TYRE ME SHËRBIMET E KUVENDIT

I. Niveli i komunikimit të institucionit në monitorim me titullarët dhe shërbimet e Kuvendit

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, është zyrtari që mban komunikimin shkresor me institucionin në monitorim, për sa i takon:

- a) përcjelljes së dokumentave të miratuara nga Kuvendi dhe për Kuvendin;
- b) kërkesave të veçanta që i bëhen institucionit në monitorim nga organe ose deputetë të Kuvendit;
- c) nënshkrimin e shkresave të nevojshme për procese dhe procedura të lidhura me monitorimin vjetor dhe të vazhdueshëm;
- ç) të tjera, për të cilat nuk është parashikuar ndryshe në këtë akt.

Për mbajtjen e raporteve dhe komunikimeve në rrugë elektronike me Kuvendin, çdo institucion në monitorim cakton një person kontakti, i cili është përgjegjës për pritjen e çdo komunikimi në rrugë elektronike dhe përcjelljen e tij tek personi/personat përgjegjës, brenda institucionit në monitorim.

Drejtuesi i Shërbimit të Monitorimit, është përgjegjës për komunikime në rrugë elektronike, për:

- a) kërkesa ose kujtesa që iu dërgohen njëkohësisht të gjitha institucioneve në monitorim;
- b) kërkesa për materiale shpjeguese ose sqarime për çështje të caktuara që nevojiten të detajohen gjatë fazës së hartimit të raportit të Monitorimit, raportit të komisionit parlamentar, ose projektrezolutës;
- c) komunikime të tjera të referuara për ndjekje nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

Këshilltari i Shërbimit të Monitorimit, është përgjegjës për komunikime në rrugë elektronike, për:

- a) kërkesa që i drejtohen vetëm njërit prej institucioneve në monitorim, që ndiqen prej tij në përputhje me rregulloren e brendshme administrative;
- b) kujtesa për respektimin e afateve të raportimit në lidhje me nivelin e zbatimit të Rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë për institucionet në monitorim që ndiqen prej tij;
- c) kujtesa për përcjelljen e raporteve periodike në komisionin përgjegjës për çështje të caktuara, siç parashikohet rast pas rasti nga raporti i komisionit, nga Rezoluta e Kuvendit ose nga vendime të komisionit përgjegjës;
- ç) të tjera, të referuara për ndjekje nga Sekretari i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Shërbimit të Monitorimit.

Çdo komunikim në rrugë elektronike, bëhet me personin e kontaktit, të njoftuar më parë nga institucioni në monitorim.

II. Raportet e drejtuesit dhe/ose këshilltarit të shërbimit të Monitorimit me komisionet parlamentare

Kryetari i komisionit parlamentar, ku bëhet raportimi vjetor dhe rast pas rasti i institucionit në monitorim, në bashkëpunim me drejtuesin e Shërbimit të Monitorimit dhe/ose këshilltarin e ngarkuar me ndjekjen e institucionit në monitorim, këshillohen për këndin kryesor mbi të cilin duhet të fokusohet raporti i monitorimit vjetor të veprimtarisë së institucionit në monitorim.

Dokumentacioni që shqyrtohet gjatë hartimit të raportit të monitorimit vjetor të institucionit në monitorim, burimi/burimet e mbledhjes së informacionit, përmbajtja dhe mënyra e përditësimit të formateve për çdo institucion në monitorim, parashikohen në rregulloren e brendshme e organizimit të shërbimeve të Kuvendit.

Në fillim të çdo viti, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, harton dhe shperndan një formular për kryetarët e Komisioneve Parlamentare, me qëllim marrjen e një vlerësimi për performancën e shërbimeve të kuvendit që angazhohen në procedura të kontrollit parlamentar si dhe për nevojat për përmirësim të procedurave të brendshme.

PJESA IV

RREGULLA PËR PËRGATITJEN E PËRMBLEDHJEVE DHE RAPORTEVE VJETORE NGA KUVENDI

I. Kalendar i shqyrtimit të zbatueshmërisë së ligjeve

Kryetarët e komisioneve parlamentare, brenda 1 muaji nga fillimi i sesionit parlamentar, hartojnë dhe miratojnë një kalendar të koordinuar për çështje që kanë lidhje me nivelin e zbatueshmërisë së ligjeve ose paketave ligjore të caktuara, sipas fushës së përgjegjësisë të komisioneve parlamentare.

Kalendari mund të përfshijë si shqyrtimin dhe analizimin e ligjeve ose paketave ligjore që rregullojnë fusha të posaçme, ashtu edhe ligje që kanë dalë për miratimin e marrëveshjeve, në veçanti atyre që kanë ndikim financiar apo social.

Në funksion të hartimit të kalendarit të sesionit të ardhshëm, shërbimi juridik dhe shërbimi i monitorimit i Kuvendit, dorëzojnë bashkërisht, pranë secilit prej kryetarëve të Komisioneve të përhershme parlamentare, propozimet për çështjet që kanë lidhje me nivelin e zbatueshmërisë së ligjeve ose paketave ligjore të caktuara e që vlerësohen prej tyre se duhet të trajtohen nga komisionet parlamentare në seanca të posaçme.

Kalendari miratohet nga Konferenca e Kryetarëve, brenda 2 muajve nga fillimi i çdo sesioni parlamentar.

Raportet e miratuara nga komisionet e përhershme Parlamentare, pas shqyrtimit të çështjeve të trajtuara e që kanë lidhje me nivelin e zbatueshmërisë së ligjeve, në çdo rast publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit.

Me vendim të Komisionit të përhershëm parlamentar, çështja mund të përcillet për trajtim në seancë plenare, sipas dispozitave të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit për përcaktimin e rendit të ditës së seancës plenare të Kuvendit. Në këtë rast Komisioni i përcjell seancës edhe projektrezolutën përkatëse me rekomandimet për institucionet përgjegjëse.

Në çdo rast, kur raporti i miratuar në komisionet parlamentare nuk i përcillet seancës

plenare, Kryetari i Kuvendit bën njoftimin publik për raportin e miratuar nga komisioni në seancën plenare më të parë.

II. Raporti i nivelit të zbatueshmërisë së rekomandimeve të Kuvendit


Pas përfundimit të të gjitha raportimeve nga institucionet në monitorim, Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit, përgatit projektraportin “Për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit”. Vlerësimi bëhet për vitin përkatës, sipas konkluzioneve që kanë dalë nga shqyrtimi i veprimtarive të institucioneve në monitorim.

Raporti shqyrtohet dhe miratohet nga Byroja e Kuvendit, i njoftohet seancës plenare dhe bëhet publik.

III. Miratimi i Kodit Etik dhe Rregullave të Sjelljes

Institucionet në monitorim, që nuk janë pjesë e sistemit të drejtësisë, miratojnë Kodin Etik dhe Rregullat e Sjelljes, të cilat duhet të mbajnë në konsideratë dhe të rregullojnë midis të tjerave etikën e funksionarit publikë të emëruar nga Kuvendi dhe normat e përfaqësimit të institucionit prej tyre tek të tretët dhe ndaj publikut. Për çdo individ që merr një emërim nga Kuvendi, duhet të jetë e qartë, që me vullnet të lirë po merr përsipër një funksion publik. Ndaj pas këtaj, e gjithë sjellja dhe veprimtaria e tij duhet të ridimensionohet, duke u përshtatur me funksionin publik dhe me qëllim që të sigurohet dhe të mos cënohet paanësia në ushtrimin e funksionit individual nga njera anë dhe funksionit të institucionit nga ana tjetër.

Raportet e vlerësimit vjetor të veprimtarisë, të hartuara dhe miratuara nga komisionet parlamentare dhe Kuvendi, duhet të përmbajnë si pikë më vete analizën e zbatimit të Kodit Etik dhe Rregullave të Sjelljes nga ana e funksionarëve publikë të emëruar si titullarë të institucioneve në monitorim ose si anëtarë të Bordeve apo Këshillave Mbikqyrëse të institucioneve në monitorim.



Tiranë, më

Zotit _____
Kryetar i Komisionit _____

Për dijëni: Zotit _____
Kryetar i Kuvendit

Çështjet që duhet të trajtojë Raporti i Shërbimit të monitorimit (pa u kufizuar):

- 1- Referencat Ligjore të nevojshme për analizimin e veprimtarisë;
- 2- Problematika të dala nga Monitorimi Vjetor dhe Periodik;
- 3- Vlerësimi i Shërbimit të Monitorimit për shkaqet dhe analiza profesionale e rastit/rasteve, përfshirë propozimet për zgjidhjen;
- 4- Vlerësimi për plotësimin e Rezolutës së Kuvendit;
- 5- Vlerësimi i Performancës së Institucionit nga këndvështrimi i Shërbimit të Monitorimit;
- 6- Vlerësimi i Raportit Vjetor të institucionit;
- 7- Propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore nëse dalin nga analiza e performancës dhe shqyrtimi i Raportit Vjetor të Institucionit;
- 8- Vlerësimi i Kodit Etik dhe të Sjelljes dhe niveli i zbatimit të Kodit të Sjelljes dhe Etikës nga titullarët ose anëtarët e bordeve të emëruar nga Kuvendi.
- 9- Të tjera në vartësi të tipologjisë së institucionit.

**Raporti nënshkruhet nga Këshilltari përgjegjës i Shërbimit të Monitorimit
Drejtuësi i Shërbimit dhe
Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI PËR _____

Dokument Parlamentar

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . _____

RAPORT
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË _____
PËR VITIN _____

Raporti duhet të referojë pa u kufizuar në:

- 1- Sqarim të përgjithshëm të përmbledhur të seancës/seancave, çështjeve të trajtuara dhe problematikës/problematikave kryesore;
- 2- Vlerësimin e zbatimit të Rezolutës së vitit të kaluar;
- 3- Vlerësimin e performancës së institucionit;
- 4- Vlerësimin e zbatimit të Kodit Etik dhe të Sjelljes nga zyrtarët e emëruar nga Kuvendi;
- 5- Mënyrën e votimit dhe qëndrimin e pakicës nëse ka.

Dokumenti nënshkruhet nga:

- Deputeti Relator dhe
- Kryetari i Komisionit të Përhershëm Parlamentar

PROJEKT - REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË _____
PËR VITIN _____

Kuvendi i Shqipërisë:

-shpjegim i fokusit të institucionit gjatë vitit për të cilin bëhet vlerësimi i veprimtarisë

Ka marrë në shqyrtim veprimtarinë e _____

- citim i çështjeve kryesore të dala nga vlerësimi i veprimtarisë dhe
- vlerësimi i performancës së institucionit gjatë vitit të kaluar

Kërkon që _____, për vitin _____ të angazhohet në këto drejtime:

- -listë të rekomandimeve të Kuvendit për tu zbatuar ose plotësuar gjatë vitit në vazhdim.

**RELACION
PER
“MANUALIN
E MONITORIMIT VJETOR DHE PERIODIK”**

Manuali bashkëlidhur këtij Relacioni ka për qëllim të rregullojë dhe detajojë Mekanizmin e miratuar me vendimin nr 49/2017 të Kuvendit “Për monitorimin e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të atyre të krijuara me ligj të veçantë” si dhe parashikon mënyrën, afatet dhe përgjegjësitë për bashkërendimin me ekzekutivin të veprimtarisë monitoruese të Kuvendit si pjesë e kontrollit parlamentar.

Pas miratimit të këtij akti, institucionet e pavarura, institucionet qendrore të administratës shtetërore dhe Kuvendi duhet të bashkëpunojnë dhe duke referuar në rregullat e propozuara në Manual gjatë ndjekjes dhe zbatimit mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

Projekt- synon plotësimin me procedura, kompetenca dhe përgjegjësi për të gjithë aktorët e përfshirë në procedurat e kontrollit parlamentar që ka në fokus institucionet e pavarura në monitorim nga Kuvendi.

Në pjesën e parë manuali përqëndrohet në përshkrimin e rregullave, dokumentacionit dhe procedurave dhe afateve që duhet respektuar në periudhën përgatitore për raportimet Vjetore të Institucioneve në Monitorim.

Manuali pasi përeakton një listë minimale dokumentash që duhet të shoqërojnë Raportin apo procesin e raportimit në përgjithësi, ndalet në mënyrë të posaçme tek disa institucione që për shkak të rëndësisë apo statusit Kushtetues, ushtrojnë veprimtari mbikqyrje në tregje shumë specifike, apo veprimtari kontrolli që prek të gjitha institucionet e administratës shtetërore.

Si të tilla mund të përmenden Banka e Shqipërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit etj. Rregullimet synojnë në përgjithësi përmirësimin e punës pasi deri tani tradita shpesh ka shkaktuar problematika të tilla si:

- Mostrajtimin e problemeve në masën e duhur;
- Komunikim gjatë seancave të raportimit me Komisionet dhe Kuvendin në mënyrë të përciptë apo duke anashkaluar çështjet, shpesh me gjuhë të mjegulluar dhe pa sqaruar deri në fund problemet;
- Cënimin e transparencës;
- Mungesën e një raporti të drejtë midis kohës që duhet të zërë fjala e përfaqësuesit të institucionit në mbledhje të Komisionit dhe komunikimit të drejtpërdrejtë nga deputetët me pyetje / përgjigje apo diskutime

Në përgjithësi në mbledhjet e Komisioneve duhet të ketë një kohë të kufizuar të leximit të raportimit nga titullari i institucionit apo në përgjithësi nga përfaqësuesi i institucionit në monitorim. Kjo sepse deputetët kanë marrë informacion përmes dokumentave që janë dorëzuar në

- Kuvend dhe mbledhjet e Komisioneve duhet të shërbejnë më shumë si mekanizma për të përcjellë mesazhe apo për të lançuar perspektivat.
Raportet Vjetore dhe të Institucionet në Monitorim duhet të përmirësojë cilësinë e raportimit në funksion të transparencës. Gjuha e përdorur në këto raporte duhet të evitojë përkthimin e shprehjeve të gatshme nga raporte të institucioneve të huaja, homologe apo të ngjashme, të cilat e mjegullojnë përmbajtjen apo mesazhin. Në standartet më të mira të transparencës, jo vetëm mosdhënia e informacionit por edhe dhënia e informacioneve me shumicë dhe të pasistemuara, konsiderohet mungesë transparence.
Për pjesën që i takon raportimit të Bankës së Shqipërisë detajimi është i domosdoshëm nëse mbahet parasysh edhe faktin që banka qendrore, pavarësisht se ka ende ligjin e '97 në praktikë, ka rritur kompetencat si rrjedhojë e zhvillimeve kryesisht mbas krizës ekonomike. Për këtë arsye është referuar grupimi i çështjeve kryesore që duhet të përfshihen në raportim. Rëndësi i jepet gjuhës së përdorur nga raportimet në përgjithësi. ECB ka nisur një traditë të shkrimit të raporteve me gjuhë të thjeshtë për publikun. Madje edhe punimet kërkimore i botojnë të shoqëruara me një përmbledhje për publikun (pra të zhveshur nga gjuha teknike).

Manuali i jep rëndësi standartizimit të komunikimit me Kuvendin në funksion të kërkesave për mbështetje buxhetore. Institucionet në monitorim, duhet t'ja nënshtrojnë kërkesat e veta për mbështetje buxhetore, llogjikës buxhetore dhe kalendarit të trajtimit nga Kuvendi të kërkesave të këtij lloji.

Për institucionet në Monitorim duhet të jetë e qartë se Kuvendi nuk bën buxhet, por miraton buxhet. Ndaj kërkesat për mbështetje nga buxheti duhet gjithmonë të jenë trajtuar dhe negociuar më parë me Ministrinë Financave dhe vetëm në raste specifike dhe të argumentuara të paraqiten edhe gjatë diskutimit të akteve që miratojnë apo ndryshojnë Buxhetin e Shtetit.

Duke mbajtur në konsideratë, kalendarin, raportet periodike dhe Vjetore që duhet të përgatisë vetë Kuvendi dhe për qëllim edhe të koordinimit të punës, institucionet në monitorim duhet të përcjellin informacione periodike sidomos për nivelin e zbatimit të rezolutave të Kuvendit.

Për këtë qëllim parashikohen të gjitha hapat që duhet të ndërmerret institucioni në monitorim, menjëherë pas miratimit të Rezolutës dhe më pas përcjelljen e informacionit periodik për Kuvendin.

Manuali rregullon në një pjesë të dedikuar Përgjegjësitë e Ministrisë të ngarkuar me marrëdhëniet me Kuvendin, mënyrën e përcjelljes së raporteve dhe autoritetin me të cilin mbahen kontaktet apo për të cilin përcillen informacionet.

Duke konsideruar që Ligje të veçanta, për shkak të rëndësisë së veprimtarisë, kanë parashikuar detyrimin që institucione të eaktuara të administratës qendrore të raportojnë në Kuvend, Manuali parashikon mënyrën e trajtimit të këtyre lloj raportimeve, llojin e akteve që miraton Kuvendi në këto raste si dhe mënyrën e shpalljes apo publikimit të tyre.

Për shkak të problematikave të hasura në komunikimin zyrtar me një pjesë të institucioneve në monitorim, manuali ka standartizuar rregullat për Nivelin e komunikimit të institucionit në monitorim me titullarët dhe shërbimet e Kuvendit.


Manuali parashikon tashmë si detyrim:

- 1- hartimin e Kalendarit të shqyrtimit të zbatueshmërisë së ligjeve duke standartizuar

- rrregulla, përgjegjësi dhe afate për hartimin e këtij kalendari. Kalendari miratohet nga Konferenca e Kryetarëve, brenda 2 muajve nga fillimi i çdo sesiioni parlamentar.
- 2- Hartimin e një Raporti përmbledhës për nivelin të zbatueshmërisë së rekomandimeve të Kuvendit;
 - 3- Miratimi i Kodit Etik dhe Rregullave të Sjelljes nga Institucionet në monitorim, të cilat duhet të mbajnë në konsideratë dhe të rregullojnë midis të tjerave etikën e funksionarit publikë të emëruar nga Kuvendi dhe normat e përfaqësimit të institucionit prej tyre tek të tretët dhe ndaj publikut.

Erjon BRAÇE

**KRYETAR I KOMISIONIT
TË EKONOMISË DHE FINANCAYE**



Ulsi MANJA

**KRYETAR I KOMISIONIT
TË ÇËSHTJEVE LIGJORE
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE TË DREJTAT E NJERIUT**

